



Formulari Formular Formular	Datë e Date Date	26.05.2022	2	viti god year
Organ-Instanca Org. Inst.	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKMHCK	3062/2022		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.359/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.359/2022, të datës 13.04.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ përmes avokatit _____ në adresë banimi _____ kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike ‘Ndërprerje e marrëdhënies së punës’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa numër A.nr.359/2022 e datës 13.04.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme në pozitën nëpunës administrativ në QKRC Obiliq sipas Akt emërimit të datës 04.01.2012, me datë 13.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2041/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme me nr.286/20 të datës 07.07.2020 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 04.05.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2572/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/19.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 2041/2022 të regjistruar me numër A.nr. 359/2022 e datës 13.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; testeve dhe Ankesave ; Autorizim i datës 07.11.2020 nga _____ për avokatin

_____ Padi për inicimin e konfliktit administrativ i datës 17.11.2020; Letërnjoftim i F.M.; Ankesën me Nr..protokollit 1433/2020 të datës 28.07.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendim Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për çështje administrative A.nr.1973/20 i datës 09.12.2021; Parashtresë precizimi i padisë në aspektin subjektiv dhe në aspektin objektiv i datës 20.12.2021; E-mail nga SH.S. për D.S. i datës 11.11.2020; E-mail nga B.G. për SH.S. i datës 12.11.2020; Vendim për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik me Nr.01/11 i datës 15.03.2020; Vendim me Nr.01/15 i datës 23.03.2020; Vendim për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus Covid-19 me Nr.01/09 i datës 13.03.2020; Vendim me nr.03/65 i datës 25.07.2014; Vendim me nr 03/146 i datës 26.06.2015; Vendim me nr.503/2016 i datës 25.07.2016; Vendim me nr. 03/40 i datës 03.11.2017; Vendim me nr.958/2017 i datës 14.12.2017; Vendim me nr. 03/11 i datës 23.03.2016; Vendim me nr. 03/42 i datës 03.11.2017; Vendim me nr.963/2017 i datës 15.12.2017; Vendim me nr. 03/43 i datës 07.11.2017; Vendim me nr. 03/50 i datës 11.10.2016; Vendim me nr. 03/17 i datës 06.07.2017; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 04.05.2022; Akt Emërim i F.M. i datës 21.12.2011; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore i datës 09.06.2020; Vendim i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me nr.286/20-04 i datës 07.07.2020; E-mail zyrtar i datës 24.04.2020; E-mail zyrtar i datës 03.06.2020; E-mail zyrtar i datës 24.04.2020; E-mail zyrtar i datës 03.06.2020; E-mail zyrtar i datës 15.06.2020; E-mail zyrtar i datës 08.06.2020; E-mail zyrtar i datës 25.06.2020; E-mail zyrtar i datës 25.06.2020; Vijueshmëria për F.M. prej datës 01.09.2019 deri 29.06.2020; Gjendja aktuale hyrje dalje prej datës 01.09.2019 deri 29.06.2020; Të dhënat në data bazë për pushime i F.M.; Lista e pagës e F.M. E-mail zyrtar i datës 08.07.2020 dhe Aktvendimin A.nr.1973/20 i datës 15.03.2022 e Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____, është e pa lejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt emërimit të datës 04.01.2012, rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në pozitën nëpunës administrativ në QKRC Obiliq në Agjencinë e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me vendimin e datës 07.07.2020 me nr.286/20 , ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndërpërje e marrëdhënies së punës" për shkak të mosparaqitjes në punë nga shtatori i vitit 2019 deri më datën 15.06.2020.

Ankuesi me datën 28.07.2020 kundër vendimit të datës 07.07.2020 me nr.286/20 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës. Meqenëse Këshilli nuk ishte funksional, me datën 14.09.2020 përmes njoftimit me numër protokollit 1750/2020 ka njoftuar ankuesin se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të fillon procedurën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Kolegji për Shqyrtimin dhe



Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi nuk ka marrë asnjë veprim lidhur me ankesën e parashtruar në Këshill ,i njëjti me datën 17.11.2020 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative. Të njëjtën ankesë ankuesi e ka parashtruar me datën 13.04.2022 me numër protokolli 2041 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht Vendimin e komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 07.07.2020 me nr.286/20, ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datë 13.04.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, ndërsa ankesa nuk është në harmoni edhe me dispozitat e përcaktuara ligjore që rregullojnë institutin e heshtjes administrative të përcaktuar në nenit 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcakton se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ."*

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.359/2022, datë 26.05.2022

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- ❖ Avokatit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

